

Kursi i Mowendos për KKP-të

Instrumente për paga dhe kushte më të mira pune

2

Dritë e gjelbërt nga Parlamenti

Natyrizimi i lehtësuar për gjeneratën e tretë

3

Stamboll: Pas një sëmundjeje të rëndë

Vdes sindikalisti Mehmet Akyol

4



Nr. 7 | nëntor 2016 | shqip

Botohet si shtojcë në gazetën «work» | Redaksia T +41 31 350 21 11, F +41 31 350 22 11 | info@unia.ch | www.unia.ch

Marrëveshjet e tregtisë së lirë TTIP, TiSA dhe CETA

Të drejta të veçanta për korporatat kundër mirëqenies shoqërore



Sektori i Unia për migracion dhe ai për rini me transparent kundër diktaturës së korporatave

TTIP, TiSA dhe CETA janë Marrëveshje ndërshtetërore për liberalizim tregtar. Ato do të çrregullojnë dhe privatizojnë shërbimet shoqërore (të njohura botërisht si Service Public), nga furnizimi me ujë deri tek spitalet. Ato vejnë interesat e korporatave mbi interesat shoqërore dhe i bëjnë varrin demokracisë dhe shtetit ligjor. Ata paraqesin rrezik për të ardhmen tonë.

Një shije paraprake na ofron shembullin e Argjentinës. Më 1999 një firmë bleu të drejtën e furnizimit me ujë për disa pjesë të Buenos Airesit. Kur qeveria e Argjentinës udhëzoi popullatën që të vlojë ujin e ndotur nga algët, shumë konsumatorë refuzuan të paguanin më tej faturat e tyre. Firma paditi shtetin. Një gjykatë e arbitrazhit dënoi shtetin e Argjentinës me një kompensim dëmi prej 165 miliona dollarësh në dobi të firmës

Privatizimi i përgjeshëm

Përmes Marrëveshjeve për tregtinë e lirë praktikisht do të privatizohen pa përjashtim të gjitha degët e ekonomisë dhe shërbimet shoqërore (Service Public) dhe ato do të nënshtrohen logjikës së tregut. Secili shtet kontraktues krijon një listë të shërbimeve shoqërore, të cilat do të hapen përjashtohen nga hapja për treg. Për gjithçka tjetër që mungon në atë listë, vlen detyrimisht hapja për treg – edhe sektorë e degë të tilla, të cilat do të nevojiten në të ardhmen. Gjithçka që një herë është hapur për treg, nuk mund të tërhiqet pas.

Kërcënim për kushtet dhe të drejtat e punës

Rreziqet për të drejtat e punëmarrësve janë të mëdha. Fjala bie në CETA mungojnë normat e vlefshme të ILO-s (Organizatës Ndërkombëtare të Punës), të cilat rregullojnë respektimin e të drejtave të punës: E drejta për mbrojtje të pushimit nga puna, për pagesë të pushimeve dhe pauzave, edhe për mbrojtje nga pagat e varfërit, për sigurimet shoqërore, etj. Atje qëndron se, palët kontraktuese duhet të përcaktojnë rishitas «standardet e pranueshme minimale të punësimit për njerëzit që marrin pagë dhe të ardhura». Si do të duken këto, kur nuk garantohej puna e denjë njerëzore.

Shkeljet mbesin të pandëshkuara

Për shkeljet e ligjit të punës nuk janë paraparë sanksione, pasi kapitulli mbi tregtinë dhe punën, mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm janë përjashtuar nga mundësitë sanksionimit. Përmirësimet përkitazi me mbrojtjen e punëmarrësve (p.sh. pagat minimale, shkurtime të orarit të punës) mund të kundërshtojnë

hen si lëndim i «pritjeve legjitime», gjegjësisht si «shpronësim indirekt».

Të drejtat e veçanta paditëse për korporatat: një kërcënim për demokracinë

Gjykatat e arbitrazhit për investitorët e huaj garantojnë të drejta të panumërta të ngritjes së padive karshi masave qeveritare. Nëse një shtet në mënyrë demokratike vendos që në ardhmen, fjala bie të largohet nga përdorimi i energjisë bërthamore, atëherë shteti mundet të pengohet të bëjë këtë për shkak të pagesave të kompensimit të dëmeve.

Një shembull: Korporata suedeze Vattenfall ka ndrit paditë për shkak të shqyrcës së reaktorëve bërthamorë në Gjermani. Për shkak të humbjeve korporata kërkon nga Republika Federale 4,7 miliarda euro.

Bashkëpunimi Rregullator në favor të korporatave

Përveç kësaj, nga principi i bashkëpunimit rregullator, ndodh edhe një dobësim i sovranitetit rregullator të parlamenteve. Kjo krijon institucione e procese, të cilat iu mundësojnë lobistëve dhe investitorëve të huaj, të intervenojnë tek legjislacioni nacional. Par se të aprovohen ligjet, partnerët tregtues, d.m.th. duhet konsultuar qeveritë e huaja dhe korporatat, për të garantuar pajtueshmërinë e ligjit me marrëveshjen e tregtisë së lirë.

Jo tej-globalizimit!

TiSA, TTIP dhe CETA atakojnë vetëvendosjen tonë demokratike dhe rrezikojnë të drejtat tona. Ne nuk duam këtë formë të globalizimit dhe refuzojmë TiSA e kompaninë.

Më shumë informata:

<http://www.unia.ch/de/arbeitswelt/von-a-z/international/stopp-tisa/>
<http://stopp-tisa.ch/wordpress/>

Çka domethënë TTIP, CETA dhe TiSA?

TTIP domethënë «Tregtia dhe partneriteti investues transatlantik». Fjala është për një Marrëveshje për tregti të lirë, e cila duhet të thjeshtëzojë shkëmbimin e mallrave dhe shërbimeve shoqërore (publike).

CETA është Marrëveshja përkatëse e tregtisë së lirë mes BE-së dhe Kanadasë.

Ajo duhet të nënshkruhet më 27 tetor të këtij viti nga qeveritë evropiane dhe më pas përkohësisht të zbatohet, para se parlamentet përkatëse nacionale ta diskutojnë mbi te.

TiSA është duke u negociuar nga një grup prej 21 shtetesh, ndër to SHBA, Japonia, BE-ja dhe Zvicra. Ajo parasheh, të gjitha shërbimet shoqërore, veçanërisht ato të Service Public, të hapen për tregun global.

Editorial



Kundër TTIP, TiSA & kompani edhe në rrugë!

Ka disa vite që BE negociu me SHBA dhe Kanada marrëveshjen për tregti të lirë TTIP dhe CETA. Me rastin e një marrëveshjeje tjetër, atë TiSA (Trade in Service Agreement) negociu edhe vet Zvicra. Të gjitha këto marrëveshje kanë të përbashkët faktin se ato janë duke u negociuar fshehurazi dhe kanë të bëjnë shumë pak me tregtinë e lirë. Fjala është për marrëveshje, të cilat para së gjithash «mbrojnë» investitorët. Mbrojtja, në këtë rast domethënë se nuk do të ketë më standarde të theksuara të mbrojtjes hapësire apo ato sociale, pasi që investitorët do të duhej të kompensoheshin nga shtetet që kanë ligje të rrepta hapësire. Pra, mund të vihen në pikëpyetje edhe standardet aktuale të mbrojtjes hapësire dhe sociale! Këto marrëveshje pra, rrezikojnë të gjitha të arriturat e lëvizjeve mjedisore dhe ato sindikaliste! Pos tjerash këto marrëveshje mund të detyrojnë pronarët e subjektet shoqërore (pra komunitat dhe shtetet) që të privatizojnë edhe ndërmarrjet dhe shërbimet publike. Ne e dimë mirë se çka domethënë kjo: pagat e të punësuarve në ndërmarrjet private zbriten, pagat e shefave të mëdhenj ngriten, ndërsa edhe çmimet e prodhimeve dhe shërbimeve sipas rregullit shtrenjtohen! Fitimet që bëjnë këto ndërmarrjeve në vend se të shkojnë për nevojat shoqërore, ato shkojnë në gjepat e investitorëve privat. Pasi që investitorët privat synojnë të arrijnë përfitime mundësisht sa më larta, të cilat i ndajnë mes veti, në vend se të investojnë në renovim apo përtëritje. Shembull i njohur është ai i hekurudhës në Angli: pasi u privatizua, investitorët privat rrjetin hekurudhor e lanë në mëshirën e minjve dhe kështu shtetit iu deshtë përsëri të marrë përsipër harxhimet e renovimit.

Në disa vende evropiane kundërshtimi karshi TTIP ka kohë që është fuqizuar. Me qindra mijëra kanë dalë në rrugë kundër TTIP. Në Zvicër rezistenca është tek tani duke u zgjuar: më 8 tetor një aleancë e gjerë në të cilën bënë pjesë edhe Unia, kanë demonstruar kundër TiSA, TTIP dhe kompani. Mirëpo ky është vetëm fillimi. Lufta kundër diktaturës së korporatave, të cilat duan të realizojnë interesat e tyre në kurriz të interesave të punëmarrësve, duhet të zhvillohet më tej.

Rita Schiavi
anëtare në udhëheqësin qendror
në Unia

News

Referendumi për mashtrimin tatimor të korporatave

Në 10 ditët e fundit komiteti për referendum ka grumbulluar mbi 70 000 nënshkrime për «JO Reformës Tatimore të Korporatave III». Nënshkrimet e vërtetuara ia janë dorëzuar në fillim të tetorit zyres federale. Reforma e aprovuar nga Parlamenti është e tepruar dhe e pabalancuar. Unia ka grumbulluar një pjesë të konsiderueshme të nënshkrimeve. Aleanca nga sindikata Unia, Partia Socialdemokrate, Partia e Gjelbër, Rinia Socialiste, Rinia e Gjelbër, solidaritës, PdA, BSHZ (SGB/USS), SEV, Syndicom, VPOD, SIT dhe Attac, janë të bindura se votuesit do të kuptojnë përpjekjen për mashtrim të mashtruese tatimor të korporatave.

Zbatimi i iniciativës të migrimit: Të mbrohen më mirë punëmarrësit

Në vendimin e qeverisë federale mbi zbatimin e iniciativës mbi migrimin mungojnë propozimet, të cilat mundësojnë mbrojtjen më mirë punëmarrësive nga keqpërdorimet. Këtë lëshim duhet sa më shpejtë ta përmirësoj Dhoma e vogël e përfaqësuesve të Kantoneve. Është për të përhëndetur vendimi i Parlamentit për heqje dorë nga kontingjentet, ashtu sikur kanë kërkuar gjithmonë sindikatat. Keqpërdorimet nga punëdhënësit, të cilët shfrytëzojnë qarullimin e lirë të personave, duhet të ndërpriten përmes masave edhe më të fuqishme gjithëpërfshirëse.

«Refugjatë mirëserdhët» – Demonstrata ne Lozanë për të drejtat e azilkerkuesve

Rreth 3000 pjesëmarrës/e të shtunën e 1 tetorit 2016 në Lozanë kërkuan një politikë më solidare të Azilit. Edhe Unia ishte pjesëmarrëse aty dhe mbështeti demonstratën. «Ndal kthimit mbrapa të refugjatëve»,



«Refugjatë mirëserdhët», apo «S'ka vend për racistët» ishin disa nga transparentet e bartura te protestuesve. Demonstrata u zhvillua pa ndonjë incident. Posaçërisht u kritikua kthimi mbrapa i refugjatëve në kuadër të Marrëveshjes së Dublinit. Protestuesit apeluan tek ministrja Simonetta Sammaruga, të rishqyrtojë praktiket e Azilit zviceran. Për më shumë informata shihni edhe: www.sosf.ch.

Osman Osmani

Dalja në pension

Propozimet e parlamentit janë të papranueshme



Demonstarta për fuqizim të pensioneve të plëqerisë

E djathta në parlamentin nacional donë që rrisë për të gjithë moshën e daljes në pension me 67 vjet. Për financimin e daljes në pension duhet të përgjaken gratë dhe të rinjtë. Të punësuarit duhet të punojnë më gjatë dhe të paguajnë shumë e më shumë. Kjo është e papranueshme.

SVP dhe FDP duan moshën e daljes në pension me 67 vjet për të gjithë. Falë shumicës së tyre në parlament ata kanë aprovuar me automatizëm dhe pa referendum të rrisin moshën e daljes në pension.

Për të realizuar këtë sa më shpejtë që është e mundur, ata kanë hequr dorë nga rritjet e propozuara të TVSH (tatimit në vlerën e shtuar) që do të ishin në dobi të daljes në pension. Kjo vetëdijshëm qon në mungesë

fondesh dhe hap rrugën për rritjen e moshës së daljes në pension.

Në kurriz të grave dhe të rinjve

«Dalja në pension 2020» prekin veçanërisht gratë. Atyre ju duhet që të punojnë një vit më gjatë pa kompensim. Edhe të rinjtë do të duhet të paguajnë më shumë. Ata duhet të llogarisin me zbritje më të mëdha nga pagat, për të kompensuar shkurtime në kolonën e dytë të sigurimit profesional pensional (zbritja e shkallës së konvertimit nga 6,8 në 6,0). Do të zbriten dhe të përkeqësohen edhe pensionet e të vejave dhe të jetimëve.

Shumë pensionistë duhet të kursejnë për qiratë

Zhvillimet e qirave në Zvicër, siç raporton edhe e përditshmja «Tages Anzeiger» e datës 30.09.2016, ka ndikim të jashtëzakonshëm në pensione: «Për rreth 122 000 pensionistë, të cilët jetojnë ende në shtëpitë apo banesat e tyre, pensionet e tyre nga të dy shtyllat e sigurimeve pensionale nuk mjaftojnë për të mbuluar koston minimale jetësore.» Për të siguruar

ekzistencën e tyre, ata marrin shtesën shërbyese plotësuese (EL/PC). Kjo shtesë për qiratë parasheh një shumë maksimale prej 1100 franga-ve në muaj për të vetmuar dhe 1250 franga për çiftet. Këto maksime qirash nuk janë përshtatur që nga viti 2001 – edhe pse mesataret e qirave nga ajo kohë janë rritur për 20%.

Varianti më i shtrenjtë

Jashtëzakonisht cinike: Të njëjtat rrethe, të cilat kanë para votimit mbi AHV/AVSplus kanë kundërshtuar ngritjen e lehtë të kontributeve të AHV/AVS duke aluduar në shkatërrimin e ekonomisë, tani më dëshirojnë të detyrojnë të punësuarit të paguajnë edhe më shumë: Kontributet e pagave për trustin pensional (Arkën e sigurimit profesional pensional) rriten varësisht nga grupi i moshës për 2 deri 5 herë se sa me AHV/AVSplus.

Osman Osmani

Sukses i punëtorëve polak të Sainte-Croix

Greva ia vlen – punëtorët marrin pagat e mbetura

Greva 16-ditëshe në Sainte-Croix ia ka vlejtur. Pas disa rundeve bisedimesh pagat e tyre të mbetura në vlerën prej 62 000 frangave do të paguhen. Kjo tregon: Ia vlen angazhimi për të drejtat tua.

Me 30 gusht 2016 gjashtë punëtorë në kantierin e firmës Alpen Peak Sainte-Croix (VD) hynë në grevë. Arsyja ishte një rast serioz i dumpingut në paga. Punëtorët për muaj të tërë morën shumë pak rrogë. Pos kësaj kishin ndodhur edhe shumë shkelje tjera të Kontratës së vlefshme Kolektive të Punës (GAV/CCT). Grevistët janë mbështetur nga Unia Neuenburg dhe Unia Waadt.

Tani është vendosur që Alpen Peak tu paguajë punëtorëve pagat e mbetura në shumën prej 62000 frangave. Vetëm falë vullnetit luftarak dhe gatishmërisë greviste të punëtorëve u arrit që të zhvillohen bisedime të suksesshme dhe të përmbyllet ky rast i dumpingut në paga.

Osman Osmani



Pamje nga greva e punëtorëve polak

Kuri i Mowendo-s mbi KKP-të

KKP janë instrumente të sindikatave

Greva 16-ditëshe në Sainte-Croix ia ka vlejtur. Pas disa rundeve bisedimesh pagat e tyre të mbetura në vlerën prej 62 000 frangave do të paguhen. Kjo tregon: Ia vlen angazhimi për të drejtat tua.

Pensionimi i mëhershëm është një temë e rëndësishme në shoqëri. Në ndërtimtarinë kryesore është arritur të sigurohet pensionimi fleksibël me 60 vjet. Edhe në degën e bojahinjëve dhe savatimit rishtas kemi një pensionim të parakohshëm me pension të plotë nga moshë 63 vjeç (për gra nga 62 vjeç). Kjo u mundësua të arrihej, pasi sindikatat në dispozicion si instrument kanë Kontratën Kolektive të Punës (KKP). Përmes tyre negocohen me punëdhënësit dhe shoqatat e tyre pagat, orari i punës, modelet e para pensionimit si dhe çështjet tjera.

ato mund të jetësohen dhe të kontrollohen. KKP e kontrolluara mirë janë me rëndësi, për të mënjanuar dumpingun në paga. Në Zvicër gjysma e punëmarrësve pposedojnë KKP-të. Në degë të ndryshme ekonomike, shembulli bie në tregtimin me pakicë, kemi edhe më tej pak KKP. Kursi i Mowendo tregon se çka nevojitet për të zbatuar KKP-të e mi. Çka duhet synuar në të ardhmen me KKP-të: më shumë pagë, pushim më të mirë për etër? Për çka duhet të angazhohet sindikata? Kursi ndërmjetëson njohuritë themelore mbi zbatimin e KKP-së dhe ofron mundësinë për shkëmbim dhe diskutim me kolege e kolegë.

Është me rëndësi që anëtarët e sindikatës të njohin KKP-të. Vetëm kështu

Beat Baumann

Adresantët:
Personat e besuar (aktivistët sindikal), anëtarët me funksione sindikaliste, anëtarët aktiv dhe sekretarët sindikal
 Numri i kursit dhe titulli i kursit
D1.8.1612 Gute Gesamtarbeitsverträge durchsetzen
 Datum/Ort: E enjte, 17 nëntor 2016 / Unia-Zentralsekretariat Bern
 Referues:
 ■ Beat Baumann (Unia)
 Kostoja e kursit
 ■ Për anëtarët: pa pagesë, përfshirë edhe ushqimi
Lajmërimi: Movendo, Postfach, 3000 Bern 23, Tel. 031 370 00 70 ose përmes www.movendo.ch

Natyrizimi i lehtësuar i gjeneratës së tretë

Pas 8 vitesh dritë e gjelbër nga Parlamenti

Të huajt e të huajat, prindërit dhe gjyshërit e të cilëve veç kanë jetuar në Zvicër, së shpejti mund të marrin në mënyre më të thjeshtë pasaportën zvicerane. Para 8 vitesh, parlamentarja e Partisë Socialdemokrate, Ada Marra ka vu në lëvizje këtë reformë, ndërsa tanimë edhe parlamenti zviceran ka pastruar diferencat e fundit. Tanimë rruga është liruar për votimin popullor.

Nganjëherë nevojitet durimi, për të korrur sukses në Parlament. Më 9 qershor 2008 parlamentarja e PSD Ada Marra ka dorëzuar iniciativën e saj parlamentare për natyrizimin e lehtësuar të huajave e të huajve të gjeneratës së tretë. Tani, pas më shumë se 8 vitesh, iniciativa ka arritur cakun, parlamenti ka aprovuar atë.

Parlamenti nacional i Zvicrës tanimë donë të mundësoi, që përgjatë 5 viteve pas hyrjes në fuqi të ligjit të ri edhe mbi 25-vjeçarët të kenë mundësi të

natyrizohen. Këtë e refuzon dhoma e vogël e përfaqësuesve të Kantoneve. Tanimë Parlamenti ka propozuar një kompromis: Përgjatë 5 viteve duhet që edhe mbi 25-vjeçarët të kenë të drejtën të aplikojnë për shtetësi, nëse nuk kanë kaluar ende moshën 35 vjeç.

Lehtësimi i natyrizimit të gjeneratës së tretë në referendum

Me pajtimin e Parlamentit është liruar rruga për votimin popullor. Kjo

është e nevojshme, pasi për këtë duhet të ndryshohet edhe Kushtetuta. Partia Socialdemokrat dhe përkrahësit tjerë presin me padurim dhe i gëzohen kësaj beteje votuese. Është në shans, për të fuqizuar faktin se ekziston edhe një Zvicër e shumëllojshme dhe e hapur, e cila të gjithë njerëzve që janë në shtëpinë e tyre këtu, u ofron edhe një Atdhe

Osman Osmani



Më 12 shkurt 2017 do të votohet për natyrizimin e lehtësuar të gjeneratës së tretë

FPagat 2017

Të rëndësishme janë rritjet e përgjithshme



Për vitin 2017 Unia kërkon rritje të përgjithshme nga 1 deri në 1,5% dhe një kontribut të punëdhënësve për premitë e arkat e sigurimeve shëndetësore. Unia pos kësaj kërkon përmbyllje të përgjithshme të pagave. Këto sigurojnë që të përfitojnë të gjithë të punësuarit nga rritja e pagave. Kështu Unia përpiqet të ndalojë ndryshimet gjithnjë e më të mëdha në paga.

Kërkesat në paga për sektorët e Unia

- **Ndërtimtari:** +80 franga për të gjithë.
- **Tregtia përmbyllëse:** 1% + shtesave për arkat e sigurimeve shëndetësore
- **Industria:** Kimia/Farmacia: së paku 100 franga për të gjithë, +120 franga për pagat mes 6000 dhe 7000 frangave, +150 franga për pagat nën 6000 frangave; LGM: së paku +80 franga për të gjithë dhe +100 franga deri në pagën prej 5700 frangave; MEM: së paku +70 franga për të gjithë, +100 franga për pagat mes 6000 und 7000 frangave, +120 franga për pagat nën 6000 franga
- **Tregtia me pakicë:** +1% përgjithësisht; për Arkat e Sigurimeve Shëndetësore: min. 45 franga /

në muaj për pagat 5000 franga; Masa speciale për punonjës shumëvjeçar.

- **Sigurimi privat:** +1% në pagat minimale të punonjësve me orar të plotë, +1.5% në pagat minimale për pagat e punonjësve me orë pune nga 4 vite përvojë pune; rritje të caktuar për punonjës me orar të pjesshëm.

Shtesat për premitë e Arkave të Sigurimeve Shëndetësore 2016

- **Industria zvicerane e mikroteknologjisë dhe e orëve** Kontributet e punëdhënësve për premitë e Arkave të Sigurimeve Shëndetësore: Për punëmarrësit me së paku se 50% orar pune: 160 franga/në muaj

Për punëmarrësit me më pak se 50% orar pune: 80 franga/në muaj Për fëmijë: 60 franga/në muaj

- **Nestlé Basel:** Shtesa për Arkën e Shëndetësisë prej 220 franga / në muaj
- **Nestlé Broc:** Shtesa për Arkën e Shëndetësisë prej 181 franga / në muaj
- **Nestlé Konolfingen:** Shtesa për Arkën e Shëndetësisë prej 205 franga / në muaj
- **Nestlé Orbe:** Shtesa për Arkën e Shëndetësisë prej 220 franga / në muaj
- **Nestlé Rorschach:** Shtesa për Arkën e Shëndetësisë prej 174 franga / në muaj
- **Philipp Morris:** Shtesa për Arkën e Shëndetësisë prej 100 franga / në muaj

Osman Osmani

Intervistë



Alexandrina Farinha

Një bashkë-kryetare me përvojë botërore

Alexandrina Farinha, bashkëpunëtore në konsullatën portugeze në Gjenevë, është bashkë-kryetare e grupit të interesit të migracionit. Horizonte ua prezanton atë.

Alexandrina, na trego diçka për ty.

Alex, për shoqërinë dhe te njohurit! dhe unë kam dy vajza që janë duke vijuar shkollën. Unë jam një optimiste ë beson se ne mund të arrijmë një botë më të mirë, nëse secili jep kontributin e vet për këtë. Unë përpiqem të marrë pjesë në kërkimin e zgjidhjeve, në vend se të jem vetëm vëzhguese.

Si ke ardhur në Zvicër?

Në tetor të vitit 2003 kam ardhur në Gjenevë. Jam zhvendosur me detyrim, pas që është hequr vendi im paraprak i punës. Ku ishe përpara? Si ishte te jesh «migrante» atje? 26 vite të jetës sime isha në Macao, Hong Kong dhe Tajvan. Të jesh «migrante» në lindje nuk është njësoj sikur në Evropë. Migrantët quhen «Expatrierte» dhe paguhen më mirë se sa vendasit. Mirëpo jo gjithçka edhe atje ishte mirë, pasi edhe në lindje migrantët/expatrierte mund të përjetojnë diskriminimin dhe racizmin. Sjelljet diskriminuese e ksenofobike nuk i gjejmë vetëm në perëndim.

Përse angazhohesh në Unia?

Ne të gjithë dëshirojmë një botë më të mirë dhe më të drejtë, mirëpo disa njerëz janë më luftarak se sa të tjerët. Këta vihen në rresht të parë. Sindikatat u takojnë radhëve të para të luftës së punëmarrësve. Në një botë ku punëmarrësit në vazhdimësi humbin të drejtat e tyre, është e pashmangshme që sindikatat të forcohen, për të pasur me shumë forcë negociimesh.

Përse je treguar e gatshme të bëhesh bashkë-kryetare e GI të migracionit?

Unë besoj se mund të kontribuoj në Unia. Puna ime është e lidhur ngushtë me tematikën e migracionit. Andaj për mua është një nder dhe shumë kënaqshme, për të pasur këtë mundësi, që njohurit dhe përvojën time të vejë në shërbim të kësaj kauze të lartë.

Çka do të doje të arrije ti si migrante dhe si sindikaliste?

Si migrante do të doja te shihja një botë të lirë, pa luftëra, kufij, ku secili e secila të kishte të drejtën të shkonte dhe/apo të qëndronte ku të donte, gjithandë ku është e mundur një jetë më e mirë dhe më e lumtur. Si sindikaliste do të doja të jepja kontributin tim modest. Ne kemi përgjegjësi, karshi atyre, që vijnë pas nesh, tu lëmi pas një botë më të mirë.

Ti i njeh sindikatat portugeze. A ka dallime?

Të gjitha lëvizjet sindikaliste kanë si qëllim kryesor, luftën për të drejta të punëmarrësve dhe në përputhje me kontekstin ekonomik e social, mund të duken edhe të ndryshe. Në ndërlidhje me krizat dhe mesat kursyese, të cilat i ka përjetuar Portugalia në vitet e fundit, ka bërë që lëvizja sindikaliste të humb fuqinë. Qeveria e mëparshme ka zhvilluar fushata brutale kundër sindikatave e sindikalistëve. Në Zvicër sindikatat janë më të shëndosha, edhe pse sindikalistët ligjërisht nuk janë të mbrojtur edhe aq mirë sikur në Portugali.

Cilat janë ëndrrat tua për të ardhmen?

Unë ëndërroj fatin me të gjithë ata, të cilët unë i dua. Unë ëndërroj për një botë, në të cilën nuk ka luftëra deh uri, të mos vdesin fëmijët, në të cilën askush nuk është i detyruar të lejë shtëpinë e tij. Në një botë ku është e mundur të jetësohen ëndrrat! Ich träume vom Glück zusammen mit denen, die ich liebe. Ich träume von einer Welt, in der es keine Kriege oder Hunger gibt, Kinder nicht sterben müssen, in der niemand ihr Zuhause verlassen muss. In der es möglich ist, Träume zu realisieren!

Për këtë ia vlen të luftohet. Kush nuk lufton, ka humbur që moti

Marília Mendes

ZËRI PROGRESIV

Manifestim i suksesshëm shqiptaro-zviceran në Bazel



Bashkëpremtar/e shqiptaro - zviceranë dhe të tjerë sindikalist/e e socialdemokrat/e nga regjioni i Bazelit.

Përveç futbollistëve me rrënjë shqiptare, është edhe një plejadë politikanësh me origjinë shqiptare që kujdesen për një vlerë të shtuar në marrëdhëniet shqiptaro-zvicerane. Dhe, këtu ka për t'u bërë vërtetë diçka.

Këtë verë në Kampionatin Evropian në Francë, veçanërisht në ndeshjen e futbollit midis Zvicrës dhe Shqipërisë, përjetuam me emocione shumë të forta. Emocione legjitime pasi gjysma e futbollistëve të kombëtares Zvicerane kanë origjinë shqiptare disa nga futbollistët më të mirë të kombëtares shqiptare janë me shtetësi të dyfishtë. Këta futbollistë vijnë nga komuniteti shqiptar në Zvicër, i cili është padyshim një histori e jashtëzakonshme suksesi. Është një komunitet që kontribuon direkt në zhvillimin e mëtejshëm të shtetit Zviceran. Diaspora shqiptare në Zvicër merr pjesë fuqishëm në botën ekonomike, akademike dhe politike të Zvicrës, duke u bazuar fort në vlerat e përbashkëta dhe në forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit reciprok.

Pikërisht për të forcuar këtë bashkëpunim, grupi socialdemokrat shqiptaro-zviceran i regjionit Bazel

në mbrëmjen e 3 Shtatorit 2016 organizoi një aktivitet shumë të suksesshëm nën moton «Të njohim vlerat e përbashkëta». Ky eveniment u mbajt në ambientet e qendrës sociale «Quartiertreffpunkt LoLa» në qytetin e Bazelit.

Përmbajtje, shumëllojshmëri dhe cilësi

Tubimi u hap dhe u moderua nga aktivisti i socialdemokratëve shqiptaro-zviceranë të regjionit Bazel, Kosta Papa, i cili fillimisht u dha mundësinë e prezantimit dy kandidatëve shqiptaro-zviceranë, Almedinda Maliqit dhe Arsim Sadriut. Më pas ai ia kaloi fjalën përshëndetëse, kryetares kantonale të Partisë Social Demokrate, Brigitte Hollinger si dhe Mustafa Atiçit, kryetar i migrantëve socialdemokratë të Zvicrës.

Tubimin e përshëndeti edhe nënkryetari i migrantëve socialdemo-

kratë të Zvicrës dhe deputeti shqiptaro-zviceran i Parlamentit Kantonal të Schaffhausen-it, Osman Osmani, i cili adresoi tri çështje preokupuese të komunitetit shqiptar në Zvicër:

Ligjin për Dëbim, i cili integrohet në Kodin Penal të Zvicrës nga 1 tetori i 2016-tës; Ligjin e ri për Natyralizim, i cili hyn në fuqi nga 1 janari i 2018-tës; Marrëveshjen e munguar ndërshtetërore mbi Sigurimet Shoqërore mes Zvicrës e Kosovës, që si pasojë janë duke u diskriminuar në mënyrë selektive prej mbi gjatë vite qytetarët e Republikës së Kosovës që kanë paguar kontributet e sigurimeve shoqërore në Zvicër.

Në vijim aktivisti tjetër i socialdemokratëve shqiptaro-zviceran, Urim Deva, prezantoi në qartë historikun e komunitetit shqiptar në Zvicër dhe marrëdhëniet shqiptaro-zvicerane.

Vlen për t'u theksuar pjesëmarrja e lartë dhe përmbajtja e këtij takimi i cili u mbyll në mënyrë festive, shoqëruar me muzikë nga trevat shqiptare, gatime dhe pije tradicionale.

⇒ Kosta Papa, aktivist sindikal

Pas një sëmundjeje të pashërueshme

Ka vdekur në Stamboll sindikalisti Mehmet Akyol



Mehmet Akyol

Ashtu, sikur e filloj jetën e tij si i rritur në Turqi në vitet e 70-ta, ashtu e ka rinisur ai jetën e tij në tri vitet e fundit të pensionimit të tij të parakohshëm. Në Stamboll, i riu Mehmet Akyol në fund të viteve të 70-ta shkruante për një gazetë kritike karshi ushtrisë dhe qeverisë. Ai u arrestua dhe u dënua me vdekje. Ia arriti të arratiset në Zvicër, ku morri azil politik. Nga viti 1982 ka punuar si sekretar sindikal. Së pari në GTCP (Sindikaten e tekstilit, kimisë dhe letrës), ku ishte përgjegjës për punëtorët/ët e tekstilit nga Turqia, më pastaj për GBI (Sindikaten e ndërtimtarisë dhe industrisë) dhe së fundi në sin-

dikatën Unia. Pas pensionimit të tij të parakohshëm në vitin 2013, ai jetonte kryesisht në Stamboll dhe merrej përsëri me shkrime. Tani për gazetën e vetme turko-kurde, për të cilën ai përpilonte artikujt për sindikatat.

Me vonesë tek ai u zbulua një sëmundje e pashërueshme, shkak i së cilës ai më 5 tetor 2016 edhe vdiq. Mehmeti ka kontribuar shumë për anëtarësinë nga Turqia në sindikatën tonë. Ai i ka këshilluar dhe ndihmuar ata, gjithandej që u mundte. Ngushëllimet tona të sinqerta për të dy fëmijët e tij, te cilët jetojnë në Cyrih.

Ju pyesni, Unia përgjigjet



Pushimi nga puna pas sëmundjes: A është i vlefshëm?

Unë jam muratorë dhe nga fillimi vitit 2013 punoj në të njëjtën firmë ndërtimtarie. Në kohë të fundit kam dhimbje të forta kurrizi. Për këtë arsye një kohë të gjatë kam qenë plotësisht i paafte për punë, që nga fillimi i marsit deri më 29 qershor 2016. Të enjten me 30 qershor 2016 kam mundur përsëri të filloj të punoj në ndërtimtarie. Menjëherë pas përshëndetjes shefi im ma komunikoi se – për shkak të gjendjes sime të përkeqësuar shëndetësore – dje përmes postës më ka pushur nga puna nga fundi i gushtit 2016: Pas kthimit nga puna me 30 qershor në shtëpi, në kutin e postës gjeta shkresën e pushimit nga puna. A është ky pushim në kundërshtim me mbrojtjen e pushimit nga puna?

PETER SCHMID: Mjerisht jo, edhe pse Kontrata nacionale e përgjithshme e punës për ndërtimtarin kryesore (LMV/CN) për raste të tilla parasheh zgjidhje bujare. Shefi juaj nuk ju ka pushuar nga puna, për kohën e kompensimit e parave ditore (LMV/CN, Neni 21.) nga sigurimi i pagës në rast sëmundjeje (apo të sigurimit obligues aksidental). Ky rregull vlen, posa të përfundoi koha provuese e punës. Paratë e fundit ditore nga sigurimi i pagës në rast sëmundjeje i keni marrë me 29 qershor 2016. Deri në këtë datë për ju ka vlejte mbrojtja e pushimit nga puna në rast sëmundjeje. Shkresën e pushimit nga puna e keni marrë një ditë më pas, më 30 qershor 2016. Dhe kjo datë vlen. Pasi që në çështjet juridike ky pushim nga puna emërtohet si «deklarim vullnetar i pranimit të prishjes së kontratës». Kjo domethënë se nuk është përcaktuese se kur përpilohet apo dërgohet një shkresa. Përcaktuese është se kur ka arritur shkresa tek ju. Ju keni marrë përmes postës shkresën e pushimit nga puna një ditë pasi që, për shkak të sëmundjeje, ka përfundua mungesa e juaj nga puna. Mbrojtja e pushimit nga puna sipas Nenit 21 të LMV/CN në këtë rast nuk vlen. Mjerisht pushimi nga puna vlen juridikisht.

work, 15.09.2016

Kujdesi ndaj fëmijëve: A kam të drejtë të bëjë pauzë më të gjatë dreke?

Unë para pak kohësh kam filluar një punë të re. Orari i punës ditore zgjat 8 orë, me një pauzë ditore prej vetëm 30 minutave. Në vendin tim të vjetër të punës kisha 1 orë gjysmë pushim dreke, kështu që kisha mundësi që në shtëpi së bashku me gruan dhe fëmijët tanë binjakë 11 vjeçar të drekonim bashkë. Shefja ime e re mjerisht nuk me lejon pauzë ë të gjatë dreke. A mund ta kundërshtojë?

PETER SCHMID: Po, ju keni të drejtë ligjore të kërkonte nga shefja juaj një pauzë prej së paku 1 ore e gjysmë në drekë. Pasi ju keni, të ashtuquajtura, obligime familjare. Kjo domethënë, ju jeni bashkëpërgjegjës për edukimin e fëmijëve deri në oshën 15 vjeç dhe për kujdesjen e pjesëtarëve të familjes me nevojë apo personave të afërm. Për raste të tilla Neni 136 i ligjit të punës për masa të veçanta mbrojtëse. Kështu punëdhënësi duhet të jetë i vëmendshëm përkitazi me përcaktimin e orarin e punës dhe atë pushimeve. Për punëmarrësit pa obligime familjare ligji kërkon me rastin e një orari pune prej më shumë se 7 orësh, një pauzë prej së paku 30 minutave. Nëse orari i punës është më shumë se 9 orë, pauza duhet të zgjas së paku 1 orë.

work, 15.09.2016

Impressum: Beilage zu den Gewerkschaftszeitungen work, area, Événement syndical | Herausgeber work, Gewerkschaft Unia, Chefredaktion: Marie-José Kuhn; Événement syndical SA, Lausanne, Chefredaktion: Sylviane Herranz; Edizioni Sociali SA, Lugano, Chefredaktion: Claudio Carrer | Redaktionskommission A. García, A. Rogalewski, D. Filipovic, E. Sariaşlan, M. Martin, M. Mendes, O. Osmani | Sprachverantwortlich Osman Osmani | Layout I. Schmieder, Unia | Druck Tagblatt Print, Im Feld 6, 9015 St. Gallen | Adresse Unia Redaktion «Horizonte», Weltpoststrasse 20, 3000 Bern 15, osman.osmani@unia.ch



Die Gewerkschaft. Le Syndicat. Il Sindacato.

www.unia.ch